



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:234724

Datë: 01.07.2024

Numri i dokumentit: 05876970

C.nr.8295/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit B.A nga GJ, Rr. "N.B" nr..., i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga M.S, avokat me seli në GJ, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit 29,871.98 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik, me datë 27.06.2024, në prezencën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të palës së paditur, me datë 01.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.A nga GJ, ashtu që: DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit, për shkak të nderprerjes së kundërligjshme të marrdhënies së punës, në emër të kompensimit të të ardhurave personale, kontributit pensional dhe tatimit në pagë për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, t'ia paguajë shumat si në vijim:

-Në emër të pagave neto të pa paguara për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, shumën e përgjithshme prej 25,444.84 € (njëzet e pesë mijë e katërqind e dyzet e katër euro e tetëdhjetë e katër cent);

-Në emër të kontributit pensional për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, shumën prej 2,844.95 € (dy mijë e tetëqind e dyzet e katër euro e nëntëdhjetë e pesë cent), shumë kjo e cila duhet paguar në llogarinë personale të paditësit në Fondin e Kusimeve Pensionale të Kosovës.

-Në emër të tatimit në pagë, shumën prej 1,582.19 € (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy euro e nëntëmbëdhjetë cent), shumë kjo e cila duhet të deklarohet në Administratën Tatimore të Kosovës.

II. OBLIGOHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit B.A nga GJ, shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me normën e kamatës ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë në Gjykatë, dt.20.10.2021, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit B.A nga GJ, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,539.60 € (një mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent), dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësi Berat Avdullahu nga GJ, përmes përfaqësuesit të autorizuar, M.S, avokat me seli në GJ, pranë kësaj Gjykate me dt.20.10.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e të ardhurave personale. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, duke kryer detyrat e punës me përgjegjësi të lartë nga data 01.06.2002, deri me datë 13.06.2012, gjatë së cilës periudhë ka punuar si zyrtar policor. Tutje theksohet se me datë 19.10.2009, paditësi është suspenduar nga puna me pagesë deri me datë 30.05.2012, për shkak të dyshimit të bazuar se i njejt i ka kryer veprën penale "Marrja e ryshfetit", nga neni 343 par.1 të KPPK-së, në bazë të vendimit të marrë nga ana e Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës, kurse nga data 30.05.2012, i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Më tej theksohet se në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.406/2013, të dt.18.09.2014, paditësi - në cilësinë e të akuzuarit është liruar nga aktakuza konform nenit 364 par.1, nënpar 1.3 të KPPRK-së për veprën penale "Marrja e ryshfetit" nga neni 343 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPRK-së dhe i njejt i aktgjykim është vërtetuar sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.649/2014, të dt.20.03.2015. Më tutje pretendohet se meqenëse paditësi është shpallur i pafajshëm për veprën penale të lartëcekur, i njejt i me aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Divizioni Civil, është kthyer në vendin e punës dhe është kompensuar në lidhje me të ardhurat personale për periudhën kohore 27.10.2009 - 31.07.2016, ndësa e paditura me dt.06.10.2020, në bazë të vendimit me numër reference 07/1-01SAP-P/5036, e ka kthyer paditësin në vendin e punës dhe e ka kompensuar lidhur me të ardhurat për periudhën kohore të lartëcekur. Megjithatë, pretendon që nuk është kompensuar në lidhje me të ardhurat personale për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, kur është kthyer në vendin e punës. Paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e këtyre të ardhurave, por e paditura e ka refuzuar përmbushjen e një obligimi të tillë, përmes përgjigjes nr.DDBN-07/027/2021, të dt.27.04.2021. Mbi këtë bazë, ka parashtruar padi në Gjykatë, duke propozuar që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia dhe të detyrohet e paditura që ta kompensojë paditësin lidhur me të ardhurat personale për periudhën kohore nga data 31.07.2016 - 06.10.2020, në shumën e cila do të përcaktohet në bazë të ekspertizës financiare, dhe atë me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 8 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunsëhëm.

Në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, si dhe fjalë përfundimare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ndër tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpdisë. Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpdisë, respektivisht përlllogaritjen e të ardhurave personale që paditësi do të kishte realizuar nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, në seancën përgaditore të dt.26.03.2024 ka propozuar nxjerrjen e provës

përmes ekspertizës financiare. Me rastin e pranimit të ekspertizës, ka deklaruar se nuk ka vërejtje ndaj të njejtës. Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.12.06.2024, ka deklaruar se pas pranimit të ekspertizës dhe dëgjimit të ekspertit, e bën ndryshimin e padisë, ashtu që tani e tutje petitumi i kërkesëpadisë duhet të jetë në këtë formë: I. Aprovohet kërkesëpadija e paditësit B.A nga GJ, ndaj paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; II. Obligohet e paditura që paditësit, për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna, ta kompensojë në lidhje me të ardhurat personale të pa paguara nga marrëdhënia e punës nga data 31.07.2016, e deri me datë 06.10.2020 dhe atë: Në emër të pagave neto shumë prej 25,444.84 €; Në emër të kontributit pensional shumë prej 2,844.95 €, si dhe në emër të tatimit në pagë shumë prej 1,582.19 €, të gjitha këto me kamatë prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe provave të prezantuara u vërtetua pa mëdyshje baza juridike e kërkesëpadisë, ndërsa lartësia e të njejtës në bazë të ekspertizës financiare, duke shtuar se Gjykata duhet t'ia falë besimin provave të administruara, e të cilat e dëshmojnë qartë se paditësi për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës nuk është kompensuar për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020. Mbi këtë bazë, ka propozuar që të vendoset si në petitum të kërkesëpadisë së precizuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të specifikuar në fjalë përfundimtare dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208.00 €; në emër të taksës për padi shumë prej 100.00 €; në emër të shpenzimeve rreth përpilimit të ekspertizës shumë prej 150.00 €; në emër të përpilimit të parashtresës për dorëzimin e dëshmisë së pagesës për ekspertin, shumë prej 208.00 €; për 4 seanca gjyqësore shumë në lartësi prej 1,081.60 € (duke llogaritur shumë prej 270.40 € për secilën seancë), në shumë e përgjithshme prej 1,747.60 €.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.04.04.2023, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadisë e paditësit, duke theksuar se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar në procedurë të brendshme administrative, sipas vendimit me ref: 07/1-01SAP-P/5036, me të cilin paditësi është kthyer në punë dhe është kompensuar lidhur me të ardhurat personale për periudhën 27.10.2009 - 31.07.2016. Më tej pretendohet se paditësi, gjatë shqyrtimit gjyqësor në çështjen C.nr.2133/13, nuk e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë edhe për periudhën kontestuese, ndërsa ndaj aktgjykimit C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017 nuk ka bërë ankesë. Tutje theksohet se e paditura me datë 05.10.2020, nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ka pranuar aktgjykimin Ac.nr.2978/17, të dt.09.09.2020, dhe me rastin e pranimit të këtij aktgjykimi ka lëshuar urdhëresë për ekzekutimin e vendimit, me numër reference 07/1-01SPA-P/5035 për rikthim në marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, në pozitën "Zyrtar në Ekipin Reagues, Ekipi Reagues "B", Sektori i Operativës, Stacioni Policor Viti (B), Sektori i Operativës Rajonale, Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, me pagë bazë 391.90 € dhe rrezikshmëri 140.00 €, me datë efektive prej dt.08.10.2020. Mbi këtë bazë, ka pretenduar se kërkesëpadija e paditësit paraqet çështje të gjykuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2978/17, të datës 09.09.2020. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar Gjykatës që të hedhet poshtë padija e paditësit, apo të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor i ka mbajtur në mungesë të palës së paditur, në mbështetje të dispozitave nga nenet 409 par.2 dhe 423 par.4 të LPK-së, bazuar në faktin se ka qenë e njoftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka prezantuar në seancë. Përmes parashtresave të

deponuara jashtë seancës gjyqësore, ka theksuar se qëndron në tërësi pranë thënieve në përgjigje në padi, ndërsa ndaj ekspertizës financiare nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje.

- *Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara* -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.27.06.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale si në vijim: Vërtetimi i punësimit, me numër reference PK/DP/AP/2389, i lëshuar me datë 06.06.2012 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; Urdhëresa për ekzekutimin e vendimit disiplinor, me numër reference 07/1-01A/2388, e dt.06.06.2012; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.406/2013, i dt.18.09.2014; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.2133/13, i dt.31.03.2017; Vendimi me numër reference 07/1-01SAP-P/5036, i dt.06.10.2020; Përgjigja në kërkesën për pagesën e diferencës në pagë, me numër reference DDBN-07/027/2021, e dt.27.04.2021; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2978/17, i dt.09.09.2020; Ekspertiza financiare nën shenjën C.nr.2133/13, e përpiluar me datë 25.07.2016 nga eksperti financiar A.B; Ekspertiza financiare e përpiluar me datë 30.04.2024, nga eksperti financiar A.B, së bashku me sqarimet plotësuese të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.12.06.2024.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç’rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga vërtetimi i punësimit, me numër reference PK/DP/AP/2389, i lëshuar me datë 06.06.2012 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, vërtetohet fakti se këtu paditësi B.A ka qenë i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitën e Zyrtarit Policor, dhe atë në periudhën 01.06.2002 - 13.06.2012.

Nga Urdhëresa për ekzekutimin e vendimit disiplinor, me numër reference 07/1-01A/2388, e dt.06.06.2012, Gjykata konstaton se është obliguar Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare - Lindje dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa - DPP, që të ekzekutojë vendimin disiplinor të plotfuqishëm të datës 30.05.2012, me numër të lëndës 71/KBD.2012, me të cilin këtu paditësi i është shqiptuar masa disiplinore “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, me efekt nga data 13.06.2012. Me të njejtën Urdhëresë, është obliguar Drejtoria Rajonale e Policiës Kufitare - Veri, që të bëjë pranimin e pajisjeve dhe kartelës identifikuese për këtu paditësin, dhe një kopje e pranimit të pajisjeve të dërgohet në Drejtorinë e Personelit, Drejtorinë e Logjistikës dhe Menaxhimit të Objekteve, DPP. Po ashtu, është obliguar Drejtoria në fjalë që me një kopje të vendimit të nënshkruar, përfshirë edhe datën e pranimit nga ana e vetë zyrtarit të njoftojë Drejtorinë e Personelit.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.406/2013, të dt.18.09.2014, këtu paditësi - në cilësinë e të akuzuarit konform nenit 364 par.1, nnëpar 1.3 të KPRK-së, është liruar nga aktakuza për veprën penale Marrja e rryshfetit nga neni 343 par.1 të KPRK-së.

Më aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.A nga GJi, janë anuluar si të kundërligjshme vendimet e të paditurës: Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor Nr.71/KBD.2012, i dt.05.04.2012 dhe Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës DPPK-01/573/2012, i dt.30.05.2012, si dhe është detyruar e paditura që në afatin kohor prej shtatë ditësh nga pranimit i aktgjykimit, ta kthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës - zyrtar policor dhe për periudhën kohore nga data 27.10.2009, deri më 31.07.2016, në emër të pagave neto t'ia paguajë shumën prej 26,657.00 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 3,107.30 € dhe tatimit në pagë në shumën prej 2,952.00 €, të gjitha këto me kamatë siç paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, 08.06.2012, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Përmes ekspertizës financiare, të përpiluar në çështjen kontestimore nën shenjën C.nr.2133/13, me datë 25.07.2016, nga eksperti A.B, është përlllogaritur fitimi i humbur i paditësit, respektivisht të ardhurat personale të cilat të njëjti do t'i realizonte si pasojë e suspendimit, respektivisht ndërprejes së marrëdhënies së punës për periudhën kohore 27.10.2009, e deri me datë 30.07.2016, duke përfshirë pagat neto, kontributet pensionale dhe tatimi në pagë. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë konstatuar dhe arsyetuar në aktgjykimin e lartëcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2978/17, të dt.09.09.2020, është refuzuar ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2133/13, i dt.31.03.2017, është vërtetuar, përveç kohës së rrjedhjes së kamatës së gjykuar, e cila është ndryshuar, ashtu që është vendosur që kamata fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit, dt.31.03.2017, e deri në pagesën definitive.

Nga Vendimi me numër reference 07/1-01SAP-P/5036, i dt.06.10.2020, të nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, konstatohet se bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018, nenin 84, paragrafi 2 si dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2978/17, të dt.09.09.2020, Drejtoria e Personelit e këtij institucioni ka nxjerrë vendim për caktimin e këtu paditësit B.A, në pozitën “Zyrtar në Ekipin Reagues”, në njësinë “Ekipi Reagues B”, me pagë bazë 391.90+Rrezikshmëria 140.00 €, me efekt nga dt.08.10.2020. Në arsyetim të këtij vendimi theksohet se i njëjti është nxjerrë me qëllim të ekzekutimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2978/17, të dt.09.09.2020.

Nga përgjigja në kërkesën për pagesën e diferencës në pagë, me numër reference DDBN-07/027/2021, e dt.27.04.2021, Gjykata konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, i është përgjigjur kërkesës së parashtruar nga i autorizuari i paditësit, av. M.S, ku ndër tjera theksohet se kërkesa për kompensimin e të ardhurave personale është pranuar dhe shqyrtuar në Drejtorinë e Personelit, ndërsa kjo e fundit, bazuar në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2978/17, të dt.09.09.2020, me dt.06.10.2020 ka lëshuar urdhëresë për ekzekutim me nr.ref 07/1-01SAP-P/5035, nga e cila urdhëresë janë përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga aktgjykimi i lartëcekur i Gjykatës së Apelit. Tutje theksohet se çështja e cila është adresuar për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kohore 31.07.2016 deri me 06.10.2020, sipas aktgjykimit të lartëcekur, nuk e obligon Policinë e Kosovës për realizimin e kësaj të drejte.

Duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, me ç'rast për ekspert është përzgjedhur A.B, nga lista e ekspertëve gjyqësorë, me detyrë që në bazë të njohurive profesionale, nga vështrimi i shkresave të lëndës dhe provat e bashkangjitura të përlllogarisë të ardhurat personale, të cilat paditësi do t'i kishte realizuar nga marrëdhënia e punës tek e paditura për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020.

Eksperti përkatës ka përpiluar mendimin me shkrim me dt.30.04.2024, me ç'rast ka dhënë këtë konstatim: *“Pagat e pa realizuara të paditësit B.A në Policinë e Kosovës, që është dashur t'i realizonte gjatë periudhës prej dt.31.07.2016 e deri me dt.06.10.2020, arrijnë vlerën si në vijim: Pagat neto të pa realizuara të paditësit arrijnë vlerën prej 25,444.84 €; Kontributi pensional arrin vlerën prej 2,844.95 €, e cila shumë duhet transferuar në Trustin e Kursimeve Pensionale të paditësit, ndërsa tatimi në paga arrin shumën prej 1,582.19 €, e cila duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës”*. Në mbështetje të dispozitës së nenit 362 par.1 të LPK-së, eksperti në fjalë është ftuar dhe ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor për të dhënë sqarimet plotësuese, me ç'rast ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë ekspertizës, e njëjta është bazuar në të dhënat e siguruara nga e paditura në raport me pagat bazë që do t'i realizonte paditësi dhe shtesat për rrezikshmëri, ashtu që bazuar në këto të dhëna, janë llogaritur pagat e tërësishtme të pa paguara për periudhën kohore 31.07.2016, e gjer me datën 06.10.2020, duke përfshirë pagat neto, kontributin pensional dhe tatimin në pagë, siç është pasqyruar në mendimin përfundmtar.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, duke marrë për bazë natyrën e kontestit, raportin juridik mes palëve ndërgjyqëse, si dhe periudhën kohore kur ka lindur ky raport, fillimisht duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit për Policinë Nr.04/L-076, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.02.03.2012. Marrëdhënia e punës në kuadër të këtij institucioni është e normuar në kreun V të këtij ligji. Neni 44, i cili flet për punësimin e personelit policor, në paragrafin 2 përcakton që: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Bazuar në këtë dispozitë, rezulton se rregullimi i marrëdhënies së punës për personelin policor është bartur në nivel të aktit nënligjor, duke i lejuar një hapësirë diskrecionale të paditurës që përmes aktit nënligjor të rregullojë marrëdhënien e punës në kuadër të këtij institucioni. Në lidhshmëri me këtë, Gjykata vlerëson se këto kompetenca diskrecionale nuk janë të pakufizuara, mirëpo përmes kësaj zgjidhje synohet vendosja e një balancimi ndërmjet respektimit të kërkesave në procedurë administrative, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, nga ana tjetër. Meqenëse dispozita e lartëcekur na referon në akt nënligjor, Gjykata i është referuar Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Në nenin 1, i cili bën fjalë për qëllimin e këtij Udhëzimi, përcaktohet që: *“Me këtë udhëzim administrativ rregullohet marrëdhënia e punës për personelin e Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Policia) si: themelimi i marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, kriteret për punësim, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit, sistemimin dhe avancimin e punonjësve në vendet e punës, orarin e punës, paga, kompensimet, shtesat dhe beneficinet, pushimet, pezullimin, ndërprerjen e marrëdhënies së punës”*. Dispozita nga neni 29, e cila i referohet të drejtës në pagë dhe shpërblim, përcakton që: *Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici.”*

Gjykata po ashtu iu referua dispozitave të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 1, e cila i referohet qëllimit të këtij ligji përcakton që: *“Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 2, e cila i referohet fushës së zbatimit, përcakton: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”*. Dispozita nga neni 55 par.1 e këtij Ligji parasheh që: *I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*. Po ashtu, dispozita e nenit 7, par.4 e këtij ligji parasheh që: *“Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin t’u lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme”*.

- Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës -

Në bazë të të gjitha provave të administruara, në ndërlidhje me deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, rezulton se nuk është kontestues fakti që paditësit B.A, në mënyrë të kundërligjshme, filimisht i është shqiptuar masa e suspendimit nga marrëdhënia e punës, me efekt nga data 27.10.2009, e më pas edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës pranë të paditurës, me efekt nga data 13.06.2012. Një fakt i tillë është konstatuar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017, i cili është vërtetuar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2978/17, i dt.09.09.2020.

Në funksion të ekzekutimit të aktgjykimeve të lartëcekura, e paditura, përmes Vendimit me numër reference 07/1-01SAP-P/5036, të dt.06.10.2020, e ka caktuar paditësin në vendin e punës *“Zyrtar në Ekipin Reagues”*, në njësinë *“Ekipi Reagues B”*, me efekt nga dt.08.10.2020.

Në këtë mënyrë, meqenëse është konstatuar kundërligjshmëria e vendimeve të të paditurës mbi suspendimin, respektivisht ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vendime këto të cilat kanë shtrirë efektet e tyre juridike nga dita e marrjes, e deri në ditën kur është ekzekutuar aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës, rezulton se paditësi është dashur t’i realizojë të gjitha të drejtat dhe beneficionet nga marrëdhënia e punës përgjatë periudhës kohore 27.10.2009 – 08.10.2020.

Gjykata mori në konsideratë pretendimin kyç të ngritur nga pala e paditur, lidhur me faktin se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, në referim të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2133/13, të dt.31.03.2017, i cili është bërë i formës së prerë sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2978/17, i dt.09.09.2020. Në funksion të vlerësimit të këtij pretendimi, për të ardhur deri në një konstatim nëse bëhet fjalë për çështje të gjykuar, duhet vlerësuar nëse janë përmbushur dy kushte (prezumime) bazike, dhe atë në mënyrë kumulative: 1) Identiteti subjektiv, që nënkupton përfshirjen e palëve të njejta në procedurat respektive, si në cilësinë e palës paditëse ashtu edhe atë të palës së paditur dhe 2) Identiteti objektiv, që i referohet objektit të kontestit, gjegjësisht kërkesave të paraqitura në këto procedura.

Në rastin konkret, ekziston identiteti subjektiv mes procedurës e cila është evidentuar nën shenjën C.nr.2133/13 dhe kësaj procedure, bazuar në faktin se kemi të bëjmë me palë të njejta të përfshira, si në anën e paditësit, ashtu edhe palës së paditur. Sa i përket identitetit objektiv, Gjykata sjellë në

vëmendje faktin se kërkesa e gjykuar në çështjen kontestimore C.nr.2133/13, konsiston në anulimin e vendimeve të të paditurës, kthimin e paditësit në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kohore 27.10.2009 – 31.07.2016. Në anën tjetër, kërkesa e paditësit në këtë çështje kontestimore është e orientuar në kompensimin e të ardhurave personale të cilat i njejtë do t'i kishte realizuar nga marrëdhënia e punës pranë të paditurës për periudhën kohore 31.07.2016 – 06.10.2020. Në prezencën e një dallimi të tillë të evidentuar sa i përket periudhës kohore për të cilën janë parashtruar kërkesat mes çështjeve respective, Gjykata konstaton se çështja e cila na është paraqitur nuk mund të trajtohet si e gjykuar (res iudicata).

Gjykata po ashtu mori parasysh pretendimin e të paditurës lidhur me faktin se paditësi, gjatë shqyrtimit gjyqësor në çështjen C.nr.2133/13, nuk e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë edhe për periudhën kontestuese. Në përgjigje ndaj këtij pretendimi, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se në procedurë kontestimore, Gjykata e urdhëron palën e paditur që të përmbushë një prestim të caktuar, vetëm me kusht që kërkesa të jetë bërë e realizueshme deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes (neni 144 par.1 i LPK). Në rastin konkret, kërkesa e paraqitur në këtë procedurë, që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kohore 31.07.2016 - 06.10.2020, nuk ka qenë e arritshme në momentin kur është përfunduar shqyrtimi kryesor në çështjen kontestimore C.nr.2133/13, vendosja e së cilës në pikëpamje të lartësisë së kërkesëpadisë ka qenë e determinuar nga ekspertiza financiare e dt.31.07.2016, në të cilën është bërë përlllogaritja e të ardhurave personale të paditësit për periudhën kohore 27.10.2009 - 31.07.2016. Për më tepër, paragrafi 3 i nenit 144 të LPK-së, përcakton që: *“Po që se premtimi që është objekt i kërkesëpadisë nuk është bërë i kërkueshëm deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, gjykata e refuzon kërkesëpadinë si të parakohshme”*. Në anën tjetër, meqenëse kundër aktgjykimit të shkallës së parë pala e paditur ka paraqitur ankesë, me ç'rast lënda është bartur për vendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës, deri në momentin e vendimmarrjes me dt.09.09.2020, rezulton se paditësi nuk ka pasur mundësi të bëjë precizim të kërkesëpadisë pranë gjykatës së shkallës së dytë në procedurën për vendosje sipas mjetit juridik (ankesës), për faktin se një veprim i tillë në aspektin procedural nuk është i lejuar.

Mbi këtë bazë, meqenëse paditësit, përmes aktgjykimeve të lartëcekura të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë i është gjykuar kompensimi i të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore 27.10.2009 - 31.07.2016, i njejtë është legjitimuar në mënyrë të plotë që të kërkojë kompensimin e këtyre të ardhurave edhe për periudhën kohore për të cilën ka mbetur pa u kompensuar nga e paditura (31.07.2016 - 06.10.2020). Një e drejtë e tillë buron nga dispozita e nenit 44 të Ligjit për Policinë, lidhur me nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (i cili ka qenë në fuqi gjatë periudhës kontestuese), si dhe nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës. Për më tepër, e paditura përmes përgjigjes me numër reference DDBN-07/027/2021, të dt.27.04.2021, e ka vënë në dijeni paditësin lidhur me faktin se çështja e cila është adresuar për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kohore 31.07.2016 deri me 06.10.2020, sipas aktgjykimit të formës së prerë, nuk e obligon Policinë e Kosovës për realizimin e kësaj të drejte. Mbi bazën e rrethanave të tilla, paditësi është legjitimuar që përmes rrugëve gjyqësore (inicimit të padisë), të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga pala e paditur për periudhën respektive, gjegjësisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa*

debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”

Në raport më vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë, Gjykata iu referua ekspertizës financiare, të përpiluar nga eksperti A.B me dt.30.04.2024, respektivisht sqarimeve plotësuese të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor. Në këtë ekspertizë janë përlloritur të ardhurat personale të cilat paditësi do t'i realizonte nga marrëdhënia pune pranë të paditurës gjatë periudhës kontestuese nga data 31.07.2016 e deri me dt.06.10.2020, duke përfshirë pagat neto, kontributet pensionale dhe tatimin në pagë, me ç'rast është dhënë ky konstatim: Pagat neto të pa realizuara të paditësit arrijnë vlerën prej 25,444.84 €; Kontributi pensional arrin vlerën prej 2,844.95 €, e cila shumë duhet transferuar në Trustin e Kursimeve Pensionale të paditësit, ndërsa tatimi në paga arrin shumën prej 1,582.19 €, e cila duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës.

Ekspertizës financiare të lartëcekur, Gjykata ia fali besimin e plotë në pikëpamje të vërtetimit të rrethanave dhe fakteve që kanë qenë të rëndësishme për vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit. E njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale, mbi bazën e të gjithë parametrave dhe standardeve të kërkuara dhe për më tepër të gjeturat nga kjo ekspertizë nuk janë kontestuar nga asnjëra palë ndërgjyqëse.

Mbi këtë bazë, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar, andaj vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë në konsideratë edhe dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

- *Vendimi lidhur me kamatën -*

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjuquara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data 20.10.2021, datë e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*. Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata, iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikës XIV të këtij Mendimi.

- *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -*

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika III e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme të krijuara në këtë procedurë, në vlerë të përgjithshme prej 1,539.60 Euro, sipas kërkesës së specifikuar, dhe atë: 208.00 € në emër të përpilimit të padisë, 100.00 € në emër të taksës gjyqësore për padi, 150.00 € në emër të përpilimit të ekspertizës financiare, si dhe shumën

prej 1,081.60 € në emër të përfaqësimit në 4 seanca gjyqësore nga ana e avokatit (4 x 270.00 €). Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Rregullores mbi Tarifën e Avokatëve (numrave tariforë 6 dhe 7). Përtej kësaj shume, Gjykata vlerëson se palës paditëse nuk i takojnë shpenzimet në emër të dorëzimit të parashtresës për dorëzimin e dëshmisë së pagesës së ekspertit në lartësinë prej 208.00 €, për faktin se një parashtresë e tillë në aspektin procedural nuk konsiderohet parashtresë në kuptim të dispozitës nga neni 99 të LPK-së.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.8295/21, datë 01.07.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.